



“Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC në kuadër të programit SENiOR-A “Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri”. Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze”  
 Nr. 9 Viti i dytë i botimit Shkurt 2014

# Ditari Naturës

## Në këtë numër do të gjeni:

- **Aktivitete të Qëndrueshme Ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare (SEA-Med) - Shqipëri.**
- **Aksion i përbashkët për Liqenin e Shkodrës.**
- **Hap dyert Ekomuzeumi i Parë në Shqipëri.**
- **Konferencë Ndërkombëtare “Ekomuzeumi i Lumit Vjosa/Aoos”**
- **Liqeni i Shkodrës si Rezervë Biosferë.**

## *Aktivitete të Qëndrueshme Ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare (SEA-Med)- Shqipëri*

INCA në bashkëpunim me zyrën për Mesdheun të Fondit Botëror për Jetën e Egër (WWF MedPO), kanë filluar zbatimin e projektit “Mbështetje e aktiviteteve të qëndrueshme ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare – Projekti për Shqipërinë”, i cili financohet nga Fondi i Partneritetit për Ekosistemet në gjendje kritike (Critical Ecosystem Partnership Fund) dhe është pjesë e një nisme rajonale Mesdhetare (Sustainable Economic Activities in Mediterranean Marine Protected Areas - SEA-Med) e cila zbatohet në 8 zona të mbrojtura detare të Libisë, Tunizisë, Turqisë, Kroacisë, Algjerisë dhe Shqipërisë. Projekti synon të mbështesë zhvillimin e turizmit në zonën e Parkut Detar Karaburun-Sazan, si e vetmja Zonë e Mbrojtur Detare në vendin tonë. Ai po zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me aktorët lokal që janë edhe partner të projektit si Administrata e Zonës së Parkut, Bashkia Orikum, Universiteti i Vlorës, organizata jo qeveritare lokale, etj. Përgjatë zhvillimit të tij, projekti do të mbështesë bizneset që janë dashamires me mjedisin në

zonë duke promovuar disa prej tyre në zhvillimin më tej dhe certifikimin e tyre me standardet evropiane. Në vijim të zbatimit të këtij projekti, më 9 Janar 2014 u zhvilluan takimet e radhës me grupin e punës aktorët dhe partnerët lokal, lidhur me ecurinë e zbatimit të projektit.

Në këtë kuadër, u zhvilluan disa takime me departamentin e turizmit në Universitetin Publik “Ismail Qemali” Vlorë, me Organizatën lokale SEEP të edukimit mjedisor, me agjencinë e zhvillimit AULEDA si dhe me Bashkinë Orikum. Çështjet kryesore të diskutuara ishin prezantimi i zhvillimeve për progresin e projektit me grupin e punës; diskutimi i planit të punës për vitin 2014; hartimi i një plani draft lidhur me studimin e bizneseve të bazuara në natyrë me Universitetin Vlorë; prezantimi me termat e referencës për certifikimin e aktiviteteve turistike në zonë dhe diskutimi i tyre me partnerët lokal. I një rëndësie të veçantë ishin diskutimet mbi forcimin e bashkëpunimit në aktivitete konkrete të vizibilitetit të vetë projektit në zonë, mundësitë konkrete të bashkëpunimit në procesin e certifikimit të aktiviteteve të qëndrueshme turistikeme ndikim në Zonën e Mbrojtur Detare Karaburun-Sazan, mbi përgatitjen e një database mbi aktivitetet turistike që gjenden në zonën Vlorë-Orikum të cilat kanë ndikim në ZMD K-S si dhe përfshirjen e departamentit të turizmit të Bashkisë Orikumit në procesin e sistemit të certifikimit të aktiviteteve të qëndrueshme që gjenden në zonë.



## *Aksion i përbashkët për Liqenin e Shkodrës.*

U zhvillua në Shkodër takimi inagurues i projektit "Mbështetje për menaxhimin e qëndrueshëm e afatgjatë të Liqenit Ndërkufitar të Shkodrës", organizuar nga zyra e IUCN për Evropën Juglindore dhe Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit. Në takim morën pjesë përfaqësues të lartë të Ministrisë së Mjedisit, të zyrës së IUCN për Evropën Juglindore, Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri, Green Home në Malin e Zi, të Qarkut dhe Universtitetit të Shkodrës, përfaqësues të shoqërisë civile, grupeve të interesit etj.



A ardhmja e qëndrueshme e liqenit të Shkodrës, kufi natyror midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, varet nga veprimet e koordinuara të të dy vendeve. Siç u deklarua në këtë takim, Zyra e IUCN për Evropën Juglindore do të bashkëpunojë me Institutin për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe Green Home në Malin e Zi, si dhe me autoritetet e zonave të mbrojtura dhe ruajtjes së natyrës për të punuar për menaxhimin efektiv të biodiversitetit në këtë liqen.

Si liqeni më i madh në Ballkan, liqeni i Shkodrës ka pare një sërë marrëveshjesh politike për përmirësimin e menaxhimit dhe mbështetjen e përpjekjeve ndërkombëtare për ruajtjen e tij. Pavarësisht vlerave të jashtëzakonshme të tij, kjo zonë përballet ende me probleme si menaxhimi i dobëti biodiversitetit dhe vlerave natyrore, urbanizimi i pa kontrolluar dhe ndërtimet e paligjshme, gjuetia pa leje dhe shqetësimi i llojeve të egra.

*"Qëllimi i IUCN është të krijojë një rrjet që të bashkojë aktoret nga Shqipëria dhe Mali i Zi dhe të mbështesë punën e tyre për menaxhimin e qëndrueshëm të liqenit të Shkodrës",* tha Z. Boris Erg, Dre-

jtor i Zyrës së IUCN për Evropën Juglindore. *"Përdorimi i mençur i biodiversitetit të liqenit do të garantojë zhvillimin e ekonomisë lokale dhe ruajtjen e vlerave dhe burimeve natyrore kësaj zone të mbrojtur për brezat e ardhshëm".* Në fjalën e saj Zv.Ministrja e Mjedisit znj. Diana Bejko, theksoi se: *"qeveria shqiptare synon të garantojë menaxhimin e integruar të ujërave duke trajtuar çështjen e menaxhimit të ujërave si nga aspekti sasior dhe përdorimit, ashtu edhe në aspektin e cilësisë së tyre.*

Ky aksion i përbashkët mbështetet nga Fondi i Partneritetit për Ekosistemet Kritike dhe synon të forcojë zbatimin e ligjit, të nxisë pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e biodiversitetit midis aktorëve kryesorë dhe menaxhereve të burimeve natyrore. Partneret do të punojnë ngushtësisht me Ndërmarrjen Publike të Parqeve Kombëtare në Mal të Zi – autoriteti i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Liqenit të Shkodrës, dhe Administratën e Zonave të Mbrojtura pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Shkodër.

Me një sipërfaqe prej 5,490 km<sup>2</sup>, liqeni i Shkodrës është më i madhi në Ballkan. Ai ka një diversitet të lartë të bimëve dhe kafshëve duke numëruar 930 lloje algash, 497 bime enëzore, dhe 430 lloje zooplanktoni dhe mikrofaune. Për këto vlera të larta të biodiversitetit, ky liqen gezon një sërë statusesh ruajtjeje kombëtare dhe ndërkombëtare – në Malin e Zi ka statusin e Parkut Kombëtar ndërsa në Shqipëri atë të Rezervës Natyrore të Menaxhuar. Në nivel ndërkombëtar ai është shpallur si zone Ramsar, zone Emerald dhe Zone e Rëndësishme për Shpendët dhe Bimët.

### **Projekti**

Projekti "Mbështetje për menaxhimin e qëndrueshëm e afatgjatë të Liqenit ndërkufitar të Shkodrës" është një projekt 3 vjeçar i IUCN që synon të nxisë menaxhimin efektiv të biodiversitetit të liqenit të Shkodrës nëpërmjet përmirësimit të praktikave dhe kapaciteteve përmenaxhimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe Mal të Zi.

[www.iucn.org/skadarlake](http://www.iucn.org/skadarlake)

## Hap dyert Ekomuzeumi i Parë në Shqipëri



Në kuadër të projektit “Ekomuzeumi i Lumit Vjosa/Aoos (Projekti VAecoM), bashkë financuar nga fondet evropiane dhe fondet kombëtare të Shqipërisë dhe Greqisë sipas Programit IPA Ndërkufitar Shqipëri-Greqi 2007-2013, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) në bashkëpunim me Bashkinë Përmet dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Përmet, organizuan më 25 Janar 2014, ceremoninë e inaugurimit të Ekomuzeumit të Lumit Vjosa/Aoos.

Pika hyrëse e këtij Ekomuzeumi së bashku me infrastrukturën e nevojshme është tashmë zyrtarisht e hapur pranë Qendrës Multifunktionale të Bashkisë Përmet. Në këtë ceremonimorë pjesë përfaqësues të qeverisë vendore në zonën e projektit, përfaqësues të operatoreve lokale në zonë, përfaqësues të shoqatave lokale mjedisore dhe kulturore. Ceremonia u përshëndet edhe nga Drejtoresha Agjencisë Kombëtare të Turizmit në Shqipëri Zj. Julinda Dhame.

### Por çfarë është një ekomuzeum?

Ky term është prezantuar për herë të parë nga muzeologu Francez Hugues de Varinene në 1971.

Një ekomuzem është një mënyrë në të cilën komuniteti ruan, interpreton dhe menaxhon trashëgimitë e tij drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Me fjalë të tjera një ekomuzeum është identiteti, natyra, kultura e një vendi, bazuar gjërësisht në një pjesë marrjelo-kale si dhe synon rritjen e mirëqenies dhe zhvillimin ekomuniteteve lokale. Një ekomuseum është një instrument i konceptuar, stiluar dhe operuar së bashku nga një autoritet publik dhe popullata e tij lokale. Përfshirja e Autoritetit publik, bëhet nëpërmjet ekspertëve të tij, objektet dhe burimet që ajo ofron, përfshirja e popullatës lokale varet nga njohuritë e aspiratat e saj dhe qasjes individuale. Ajo është një pasqyrë në të cilën popullsia lokale shikon vetveten për të zbuluar imazhin e saj, ku ajo kërkon dhe gjen një shpjegim për territorin të cilit i përket, për kulturën dhe popullsinë që i ka paraprirë, përmes ecurisë së brezave. Kjo është një pasqyrë që popullsia lokale e ngre dhe e mban për vizitorët e saj në mënyrë që të përçojë tek ta sa më kuptueshëm dhe tërheqës informacionin për industrinë, zakonet dhe identitetin e vendit të cilit i përket dhe të marrë në këtë formë pas, edhe admirimin dhe vlerësimin plot respekt të vizitorëve. Ajo është një shprehje e njeriut dhe natyrës. Ajo e vendos njeriun në mjedisin e tij natyror dhe përshkruan natyrën me egërsinë e saj, por njëkohësisht e përshat atë me imazhin e aspekteve tradicionale.

## Konferencë Ndërkombëtare “Ekomuzeumi i Lumit Vjosa/Aoos”

Inagurimi i Ekomuzeumit të lumit Vjosa/Aoos u pasua një ditë më pas me një udhëtim dhe vizitë në disa nga pikat me atraktive të luginës së lumit Vjosa/Aoos në pjesën Greke si dhe një Konferencë Ndërkombëtare të përbashkët Shqiptaro-Greke, që u organizua në ambientet e Bashkisë Konicë, Greqi në datat 26-27 Janar 2014. Nga pala shqiptare në këtë aktivitet morën pjesë 28 përfaqësues të rrjetit të operatoreve lokale, pushteti lokal, partnerë të projektit si dhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Turizmit në Shqipëri. Konferenca u për-

Vijon në faqe 4



*Vijon nga faqe 3*

shëndet nga Kryetari i Bashkisë Konicë, Kryetari i Bashkisë Zagori në Greqi, Kryetari i Bashkisë Përmet, Kryetari Bashkisë Këlcyrë në Shqipëri, Menaxheri i Parkut Kombëtar Vikos-Aoos dhe Pindus në Greqi, si dhe Drejtori i Shërbimit Pyjor Përmet, Shqipëri.

Konferenca kishte për qëllim të shënonte hapjen e Ekomuzeumit në të dy vendet si dhe të prezantonte konceptimin dhe përmbajtjen e tij e një kohësisht, të siguronte mundësinë për të diskutuar rreth potencialit që ky Ekomuzeum do të ketë për zonën përreth në të ardhmen.

Konferenca shënoi zyrtarisht krijimin e një rrejtje të përbashkët pune Shqiptaro-Grek për menaxhimin e Ekomuzeumit. Përfaqësuesit e këtij rrejtje në dy vendet patën mundësinë të firmosnin për gjatë kësaj konference edhe një Memorandum të Përbashkët Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi. Rrjeti i përbashkët i punës për ekomuzeumin ka si anëtar të tij përfaqësues të pushtetit lokal dhe operatoreve lokale, individ dhe ekspertë lokal përreth zonës së projektit në dy vendet. Ky Memorandum Mirëkuptimi nënvizon objektivat dhe aktivitetet menaxhuese të Rrjetit të përbashkët të punës së Ekomuzeumit Vjosa/Aoos. Ai bën të qartë mënyrën e komunikimit, ndarjen e informacionit, procesin e konsultimit, strukturat drejtuese të Rrjetit të Punës dhe burimet e autoritetit. Në bazë të tij, rrjeti i punës i përbashkët për ekomuzeumin do të veprojë përmes strukturave të veta dhe do të menaxhohet nga anëtarët e Rrjetit në të dy vendet dhe drejtimi i tij do të bëhet nga të gjithë përfaqësuesit në strukturën e organizuar në Asamblenë e Përgjithshme.

Një vend të veçantë në këtë konference zuri dhe çështja tashme shumë e diskutuar lidhur me një plan të Qeverisë Greke për devijimin e lumit Aoos. Në këtë kuadër u bë e ditur se një grupim shoqatash dhe përfaqësuesish të pushtetit lokal në Greqi janë bashkuar për të kundërshtuar dhe mos lejuar një ndërhyrje të tilla me impakt negativ për jetën e komunitetit përreth ashtu edhe në mjedisin në tërësi. Devijimi i rrjedhës së lumit Aoos pritet të ketë jo pak impakt edhe në pjesën shqiptare të lumit Vjosa, për këtë arsye përfaqësuesit e pushtetit lokal përgjatë lumit Vjosa në Shqipëri, të pranishëm në konference, iu bash-

kuan grupimit grek me moton “të mos lejojmë që atë që natyra ka krijuar ne tashkatërrojmë”.

Dita e pare e konferencës u mbyll përmes një darke festive pjesë e së cilës ishin edhe dy grupe muzikantësh Shqiptar dhe Greke të cilët sollën për pjesëmarrësit pjesë muzikore e këngë tradicionale nga muzika folk e të dy vendeve.

Dita e dyte e Konferencës shënoi shkëmbimin e informacionit rreth punës së kryer nga partneret e projektit në të dy vendet si dhe nga modele të tjera ekomuzeumesh nëpër botë. Një vlerësim i veçantë për projektin dhe ekomuzeumin u dha edhe nga Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Turizmit në Shqipëri e cila nënvizoi rendësinë e këtij ekomuzeumi për promovimin e vlerave, traditave dhe kulturës së të dy vendeve si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe miqësisë mes dy popujve miq. Ajo theksoi se kjo iniciative do të ketë në vazhdimësi edhe mbështetjen e padiskutueshme të Agjencisë Kombëtare të Turizmit në Shqipëri.

Tashmë Ekomuzeumi ndërkufitar i lumit Vjosa/Aoos, ingritur përmes iniciativës së katër organizatave në Greqi dhe Shqipëri (Instituti Mesdhetar për Natyrën dhe Anthropos (Med-INA), Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), Pindos Perivallontiki dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor Përmet), synon të promovojë dhe të ruajë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të hapësirës së zgjeruar të basenit të lumit Vjosa/Aoos.

Pas përfundimit të projektit në Shkurt 2014, menaxhimi i ekomuzeumit do të kalojë në duart e rrjetit ndërkufitar të ekomuzeumit. Kjo është një arsye kryesore shumë e nevojshme për të siguruar bashkëpunimin e duhur mes banorëve dhe organizatave me anëtarët dhe partnerët e projektit në kuadër të konsensusit dhe bashkëpunimit.

Në të ardhmen, ne shpresojmë që projekti do të ketë ndikim pozitiv në aspektin socio-kulturor, ekonomik dhe mjedisor në këtë rajon kufitar dhe se ky bashkëpunim do të përmirësojë komunikimin midis popujve të dy rajoneve dhe dotë kontribuojë në përgjithësi në zhvillimin e bashkëpunimeve të reja në të ardhmen.

### ***Liqeni i Shkodrës si Rezervë Biosferë***

Në kuadër të projektit ndërkufitare Shqipëri-Mal i Zi “*Të mbështesim propozimin e Rezervës së Biosferës Ndërkufitare të zonës së Liqenit të Shkodrës*” si vazhdim i iniciativës së bashkëpunimit midis Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe Green Home (Mal i Zi),

u organizua në Bar (Mal i Zi) takimi përmbyllës mbi rezultatet e përpjekjeve të bëra deri me tash për shpalljen e Liqenit të Shkodrës si Rezervë Biosfere. Takimi kishte për qëllim prezantimin e arritjeve të deritanishme, informimin dhe bashkëpunimin gjithë përfshires me pushtetin

lokal, OJF-të mjedisore dhe aktore të tjerë vendore përreth Liqenit të Shkodrës, situatës aktuale, mbështetjes të institucioneve qendrore e lokale si edhe të hapave që duhet të ndiqen në të ardhmen të këtij procesi. Në takim u prezantua edhe eksperianca e sukseshme për një përpjekje të ngjashme në zonën e Liqeneve të Ohrid dhe Prespës. Projekti për shpalljen e Liqenit të Shkodrës si Rezervë Biosfere ka një moment ngadalësimi për arsye të qëndrimit jo të qartë të institucioneve në Malin e Zi dhe për këtë arsye po kryhet një studim fizibiliteti, për të parë mundësinë dhe mbështetjen ose jo të kësaj iniciative nga institucionet qendrore në të dy vendet.



## NJOFTIME

- 1- Vacancy: Deputy Executive Secretary;** GWP is looking to recruit a Deputy Executive Secretary, to be based in the Global Secretariat in Stockholm. For full details on the position, please read the announcement on our vacancy page: <http://www.gwp.org/About-GWP/Vacancies-and-Internships/Deputy-Executive-Secretary/> The deadline for submissions of applications is **10 February 2014**.
- 2- Programet e MSc apo Phd ne fushen e Energjise** lehtesohen dhe promovohen nga Instituti Evropian i Inovacionit dhe Teknologjise. Për më tepër: (<http://eit.europa.eu/>)

## Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në buletin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes buletinit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme. Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!**
- Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.**

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës  
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro